

Rregullore e Atlas-it tek kontrata e integritit

Parimet e rëndësishëm në Atlas

- një dhënie shërbimi e barazvlefshme për të gjithë personat që integrohen
- respekt dhe mirësjellje
- jo dhunë

Regjistrim i të dhënave të tua

- Atlas-i regjistron të dhënat e tua në një dosje personale. Regjistrimi është i nevojshëm për trajektin tënd të integritit. Atlas-i respekton privacinë tënde.
- Atlas-i i kërkon dhe jep informacione mbi trajektin tënd të integritit organizatave relevante. Atlas-i nuk komunikon informacione personale.
- Nuk fillon e fillon një kurs? Apo mungon tepër herë?
Atëherë udhëzuesi yt i trajektit e komunikon këtë informacion tek Sociale Dienstverlening (OCMW) apo VDAB.

Mësime dhe shërbime online

Atlas-i i gjykon aftësitë dixhitale si të rëndësishme. Një pjesë e mësimeve dhe shërbimeve është online.

- Atlas-i teston aftësitë e tua dixhitale në fillim të trajektit tënd. Nuk mund të ndjekësh mësim online? Të duket puna online e vështirë? Ti ushtrohesh dhe mëson nëpërmejt Atlas-it.
- Ti e siguron vetë një kompjuter, laptop apo tablet për kursin Orientim në Shoqëri (MO). Nuk ke kompjuter, tablet apo laptop? Ti mund të huazosh tek Atlas-i një tablet për kursin MO. Një punonjës të informon.

Trajekti i integritit

Je i/e detyruar të ndjekësh trajektin e integritit?

Atëherë ka marrëveshje të veçanta:

- Nuk mund të marrësh pjesë në një kurs? Apo të duhet t'a ndryshosh kursin?
Atëherë ti duhet të kesh një arsye zyrtare. Kontakto udhëzuesin tënd të trajektit për informacion!
- Në disa situata mund të të jepet një dënim/gjobë:
 - Ti nuk e fillon kursin Orientim në Shoqëri dhe/ose mësime të holandishtes.
 - Ti ke munguar tepër herë në kursin MO dhe/ose në mësime të holandishtes.
 - Ti ke një takim për një test dhe ti nuk e bën testin.
 - Ti nuk punon dhe ti nuk regjistrohesh tek VDAB-ja.
 - Ti nuk punon as nuk studion dhe nuk bën 40 orë trajekt të pjesëmarrjes/angazhimit në shoqëri.
 - Udhëzuesi yt i trajektit të kontakton dhe ti nuk reagon.
 - Ti nuk dëshiron të paguash.

Nuk je i/e detyruar të ndjekësh trajektin e integritit?

Atëherë ka marrëveshje të veçanta:

- Atlas-i e ndalon/mbyll trajektin tënd në këto situata:
 - Ti vendos vetë të ndalosh trajektin e integritit.
 - Ti nuk e fillon 2 herë kursin MO, apo mësimet e holandishtes.
 - Ti nuk ndjek për 6 muaj asnjë kurs MO, apo mësimet të holandishtes.
- Dëshiron më vonë të nënshkruash përsëri një kontratë integrimi? Kjo është e mundur.
Vini re: Ndoshta ti duhet të paguash për kursin MO dhe holandisht.

Ti don të shkosh tek Atlas-i. Çfarë duhet të bësh?

- Merr një takim me udhëzuesin tënd të trajektit apo me një shërbim të Atlas-it.
- Kalo gjithmonë së pari tek recepsioni! Mos shko drejtpërdrejt tek udhëzuesi yt i trajektit!
- Prit qetësisht në sallën e pritjes! Në ekranin në sallën e pritjes, e shikon se kur të vjen rradha.
Vini re: ndonjëherë vijnë shumë njerëz në Atlas. Në atë rast duhet të presësh më gjatë.

Çfarë pret Atlas-i nga ti?

- Ti vjen në orar në takimin tënd, mësimin tënd apo testin tënd.
- Nuk mund të vish në takimin tënd apo në testin tënd? Kontakto gjithmonë një punonjës apo shërbimin!
- Ke ndonjë pyetje? Kontakto vetë një punonjës!
- Ti merr pjesë aktivisht në trajektin e integritit.
- Nuk lejohet të pish duhan, të jesh i/e pirë apo i/e droguar në Atlas apo në kursin MO.
- Nuk lejohet t'i japësh para apo dhurata një punonjësi.
- Ti i respekton marrëveshjet ndërmjet teje dhe udhëzuesit tënd të trajektit.
Ti i respekton marrëveshjet gjatë kursit MO.
Udhëzuesi i trajektit dhe mësuesi i MO i diskutojnë marrëveshjet me ty.
- Ke fëmijë? Kërkoji ndonjë të njohuri t'i ruajë fëmijët e tu! Kështu ti mund të flasësh qetësisht me punonjësin, apo mund të përqendrohesh më mirë në mësim ose në test/provim.

Ke ndonjë pyetje?

Kontakto udhëzuesin tënd të trajektit!

Ose dërgo e-mail tek atlas@antwerpen.be.

Ke ndonjë ankesë?

- Ti mund të dorëzosh një ankesë me anë të formularit në faqen e internetit të Atlas-it:
www.atlas-antwerpen.be/nl/contact/klachtenformulier
- Atlas-i e heton ankesën tënde dhe të kontakton.
- Nuk është trajtuar mirë ankesa jote? Kontakto avokaten e popullit të Antwerpen-it (ombudsvrouw):
www.antwerpen.be/nl/overzicht/ombudsvrouw/nieuws!

Atlas-i të uron shumë suksese në trajektin tënd të integritit!

Marrëveshje ndërmjet teje dhe udhëzuesit tënd të trajektit

Çfarë bën udhëzuesi yt i trajektit?

- Udhëzuesi yt i trajektit të udhëzon në një gjuhë që ti e flet dhe e kupton.
- Udhëzuesi yt i trajektit është diskret me pyetjet e tua dhe informacionet e tu personale.
- Udhëzuesi yt i trajektit të sqaron qëllimet dhe vlerën e shtuar/rëndësinë e trajektit të integrit.
- Udhëzuesi yt i trajektit të sqaron se si mund t'i arrish këta qëllime.
- Ju diskutoni bashkë mbi qëllimet/ambiciet e tua (për shembull: të punosh, të studiosh, të njihesh me njerëz).
- Udhëzuesi yt i trajektit jep informacione mbi të drejtat dhe detyrimet e tua gjatë trajektit tënd të integrit.
- Ke ndonjë pyetje mbi ndonjë temë apo situatë? Ti e kërkon vetë përgjigjen. Udhëzuesi yt i trajektit të këshillon/stërvit. Pra ti nuk merr gjithmonë menjëherë një përgjigje.
- Udhëzuesi yt i trajektit ka ekspertizë mbi jetesën në Flandër. Udhëzuesi yt i trajektit të drejton/adreson në rast pyetjesh mbi:
 - punën
 - studime të mëtejshëm
 - njohjen e diplomës tënde
 - një shkollë për fëmijën tënde
 - aktivitete në kohën tënde të lirë, apo punë vullnetare
 - ...
- Udhëzuesi yt i trajektit i ndjek veprimet e tu të trajektit tënd të integrit:
 - praninë tënde në kursin MO dhe në kursin e holandishtes
 - rezultatet e tu të kursit MO dhe të testit MO
 - regjistrimin tënd tek VDAB-ja.
 - 40 orë aktivitete sociale në holandisht (trajekti i pjesëmarrjes/angazhimit në shoqëri)

Udhëzuesi yt i trajektit të jep reagimet e tij (se si kanë shkuar gjërat).

Nuk i ndjek marrëveshjet e trajektit të integritit? Ty mund të të jepet një dënim/gjobë.

- Gjatë trajektit të integritit ti ke disa kontakte me udhëzuesin tënd të trajektit.
Kontaktet mund të bëhen me anë të një bisede në Atlas, telefonit, mesazhit SMS, bisedë me video, e-mail, ose WhatsApp.
Udhëzuesi yt i trajektit të informon se kur janë të mundur ata kontakte.
- Ke një takim tek udhëzuesi yt i trajektit dhe udhëzuesi yt i trajektit është i/e sëmurë?
Një punonjës të kontakton: ne e anulojmë takimin ose e trajtojmë pyetjen/kërkesën tënde.
- Ti nuk mund t'a zgjedhësh vetë udhëzuesin tënd të trajektit. Ti nuk mund të ndryshosh udhëzuesin e trajektit.
Të gjithë udhëzuesit e trajektit ndjekin të njëjtat rregulla.

Çfarë bën ti gjatë trajektit të integritit?

- Ti respekton marrëveshjet e kontratës së integritit dhe rregulloren e Atlas-it!
- Ti merr nismë/iniciativë gjatë trajektit tënd të integritit.
- Të kontakton ty udhëzuesi yt i trajektit? Ti reagon gjithmonë.
- Ndryshon situata jote personale?
 - Ti ke një adresë të re.

- Ti ke një numër të ri telefoni, apo një adresë të re e-maili.
- Ti ke gjetur punë. Apo ti nuk punon më.
- Situata jote e qëndrimit ndryshon.
- Ti e ndryshon emrin tënd.

Atëherë kontakto gjithmonë, menjëherë udhëzuesin tënd të trajektit!

- Dëshiron **të bësh njohjen/njësimin e diplomës** tënde?

Atlas-i mund të të ndihmojë për procedurën tek NARIC-Vlaanderen. Një punonjës të informon se cilët dokumenta nevojiten.

Atlas-i mund të dërgojë dosjen tënde tek NARIC-Vlaanderen deri **maksimumi** 3 vite pas datës së kontratës tënde të integrimit.

Silli dokumentat e tu tek Atlas-i **maksimumi (jo më vonë se)** 3 muaj para asaj date të skadencës!

Punonjësit i nevojitet kohë për të përgatitur dosjen tënde.

Ka përfunduar trajektin yt i integrimit?

I ke arritur qëllimet e trajektit të integrimit? Udhëzuesi yt i trajektit të jep një vërtetim të integrimit.

Udhëzuesi yt i trajektit nuk të udhëzon më.

Marrëveshje mbi kursin Orientim në Shoqëri (MO)

Marrëveshjet janë/vlejnë:

- për të gjithë kursistët
- për të gjithë mësimet online
- për të gjithë mësimet në klasë
- për të gjitha detyrat
- për të gjithë aktivitetet me grupin tënd të klasës.

Si është organizuar kursi MO?

- Ti bashkëpunon me personat e tjerë që integrohen, për të arritur qëllimet e Orientimit në Shoqëri. Ata qëllime përshkruajnë:
 - çfarë duhet të kuptosh ti në fund të kursit
 - çfarë duhet të jesh ti i aftë të bësh në fund të kursit
 - cilat vlera dhe norma janë të rëndësishme.
- Në kurs të jepen mësimet, detyra dhe aktivitetet. Të gjithë mësimet, detyrat dhe aktivitetet janë të rëndësishëm për:
 - t'i arritur qëllimet e MO
 - të kaluar me sukses vlerësimin gjatë kursit
 - të kaluar me sukses testin MO pas kursit
- Ti e ndjek kursin një pjesë online dhe një pjesë në klasë.
- Ti e ndjek kursin në një gjuhë që ti e flet dhe e kupton. Ti di të shkruash dhe të lexosh në gjuhën e kursit. Për disa kurse ti nuk duhet të jesh i aftë të lexosh apo të shkruash.
- Mësimi të jepet nga 1 ose më tepër mësues.
- Ti je vetë përgjegjës për veprimet e tu në kurs dhe për rezultatin e testit tënd MO.

Çfarë ke nevojë për një kurs online MO?

- një **kompjuter, laptop ose tablet**.
Mësimin nuk mund t'a ndjekësh me një smartphone (telefon).
- një **adresë e-mail-i personale**
Ty të jepet një profil (Ilogari) në Google për të ndjekur kursin MO. Për atë profil të nevojitet një adresë e-mail-i. Nuk ke adresë e-mail-i personale? Atëherë Atlas-i hap një adresë e-mail-i për ty. Ti duhet të mësosh t'a pëdorësh adresën e e-mail-it në telefonin tënd (smartphone).
- **njhuri dixhitale bazë**
Për mësimet dhe detyrat online ty të nevojiten aftësi dixhitale. Ti mund të ushtrohesh dhe mësosh nëpërmjet Atlas-it.
- **kufje tuajat që vendosen mbi vesh apo që futen në vesh**
Kështu të tjerët afër teje nuk i dëgjojnë kursistët e tjerë dhe mësuesin. Kjo është e rëndësishme për privatësinë.
- një **vend i qetë**
Kështu ti mund të përqendrohesh dhe të thuash çfarë dëshiron.
- Ke huazuar një tablet tek Atlas-i?
Respekto marrëveshjet e dokumentit 'Të huazosh një tablet nga Atlas' ('Een tablet lenen van Atlas')!
- Ke **fëmijë?**
Kërko një çerdhe/kopësht/vend për t'i ruajtur!

Cilat janë rregullat në ndërtesa?

- Lejohet të pish duhan vetëm në hapësirën ku lejohet të pihet. Nuk lejohet të pish duhan në ndërtesë, para portës së shkollës, apo në sheshin e lojrave (oborr).
- Vjen me një step? Step-i yt nuk lejohet të lihet në korridor. Vendose step-in tënd në vendparkimin e biçikletave!
- Vetëm **kursistët e MO** lejohen të hyjnë në ndërtesën e kurseve MO. Dëshiron të sjellësh me vete një person tjetër? Atëherë pyete më përpara mësuesin tënd!

Çfarë është e rëndësishme për vlerësimin e kursit tënd MO?

Atlasi bën 2 vlerësime:

1. Mësuesi të vlerëson gjatë kursit.
2. Ti bën një test pas kursit.

Të gjithë informacionet i lexon në rregulloren e vlerësimit të kursit Orientim në Shoqëri.

Çfarë pret Atlas-i nga ju gjatë kursit?

- **Ndiq të gjithë mësimet dhe aktivitetet!** Kjo është e rëndësishme për:
 - mësuesin tënd. Mësuesi yt përdor informacione nga mësimet e mëparshëm dhe detyrat e mëparshme në mësimet e ardhshëm.
 - grupin tënd të klasës. Ti njihesh me kursistët në klasën tënde. Ju mësoni nga njëri-tjetri.
 - veten tënde. Ty të nevojiten informacionet nga mësimet dhe aktivitetet. Mungon shumë herë? Atëherë mësuesi të jep një vlerësim negativ.
- **Eja në orar!**
- **Ndiqe mësimin nga fillimi deri në fund!** Mos planifiko takime të tjera gjatë mësimit!
- **Merr pjesë aktivisht** në mësim dhe në aktivitete!
- Të jepet një detyrë? **Ti e bën detyrën.** Jepja detyrën në datën e rënë dakord mësuesit tënd.
- **Ulja krejtësisht volumin telefonit tënd celular, ose fike atë!** Përdore telefonin tënd celular vetëm për ushtrime!
- **Respekto kursistët e tjerë!:**
 - Mos publiko shprehje të kursistëve të tjerë, apo të mësuesit në mediat sociale!
 - Dëgjo kur flet dikush!
 - Jefe mendimin tënd në mënyrë të sjellshme/me respekt!
 - Respekto mendimin e kursistëve të tjerë!
 - Bashkëpuno me kursistët e tjerë!
 - Lëri kursistët e tjerë të ndjekin kursin të qetë!
- Gjatë **mësimeve online:**
 - ndize/hape kamerën tënde gjatë të gjithë mësimit!
 - tregoje fytyrën tënde!
 - ulu para ekranit!

Dëshiron t'a kontaktosh mësuesin tënd?

- Kontakto mësuesin tënd në **periudhën e kursit tënd!** e leerkracht. Kontakto mësuesin tënd gjatë orarit që mësuesi yt punon.
- Mbaroi kursi yt? Kontakto udhëzuesin tënd të trajektit!

Dëshiron t'i kontaktosh kursistët e klasës tënde?

Në shumicën e rasteve një grup i klasës ka një **grup në WhatsApp**.

Dëshiron të kontaktosh personalisht një kursist? Atëherë pyete më përpara kursistin nëse kjo lejohet!

Nuk mundesh të vish? Je me vonesë?

- Kontakto mësuesin tënd para se të fillojë mësimi apo aktiviteti!
- Ti jep një arsye zyrtare: ti je i/e sëmurë, apo është një situatë urgjente (e papritur).
- Mungon në fillimin e kursit? Atëherë ti nuk mund të marrësh pjesë më në atë kurs. Nuk lejohet as të marrësh pjesë në test.
- Ti kërkon nga mësuesi informacione mbi mësimin apo aktivitetin. Ti e përpunon vetë informacionin!

E anulon mësuesi yt mësimin?

Mësuesi yt të jep një detyrë. Nuk e bën detyrën? Atëherë mësuesi yt e regjistron si mungesë për ty.

Vini re:

Nuk i respekton marrëveshjet? Atëherë Atlas-i shqyrton situatën dhe vendos se çfarë mase merret.

Këto masa mund të jenë:

- Të jepet një paralajmërim.
- Ti duhet ta ndalosh mësimin.
- Ti ke një takim për të folur me udhëzuesin tënd të trajektit ose me mësuesin tënd.
- Të jepet vlerësim negativ për kursin.
- Ti duhet t'a ndalosh krejtësisht kursin.

Ju urojmë suksese në kursin tënd Orientim në Shoqëri!